

20100360629

## L I G J

### **PËR NGARKIM ME BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM NË KËSHILLIN EVROPIAN SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË PËR HUA PËR FINANCIM TË PJESSHËM TË PROJEKTIT PËR RIKONSTRUKTIM DHE NDËRTIM SHITESË TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE PUBLIKE-FAZA E PARË**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka për Zhvillim pranë Këshillit Evropian me hua në shumë prej 23 000 000 eurosh, për financim të pjesshëm të Projektit për rikonstruktim dhe ndërtim shtesë të institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Maqedonisë - faza e parë.

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve nga huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen kornizë për hua për financim të pjesshëm të Projektit për rikonstruktim dhe ndërtim shtesë të institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Maqedonisë - faza e parë, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim pranë Këshillit Evropian.

Kushtet për shfrytëzimin e mjeteve të çdo transhe veç e veç, do të përcaktohen me Marrëveshjet plotësuese për hua, të cilat janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes kornizë për hua për financim të pjesshëm të Projektit për rikonstruktim dhe ndërtim shtesë të institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Maqedonisë - faza e parë.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen kornizë për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

#### Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji, është më së shumti 20 vite, duke e përfshirë grejs periudhën prej pesë vitesh.

Transheja e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh, nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 33% nga shumata e përgjithshme e huas.

Tërheqja e çdo transhe të ardhshme, do të realizohet pasi që Republika e Maqedonisë me shkrim do ta njoftojë Bankën për Zhvillim pranë Këshillit Evropian, se 90% nga shumata e transhesë së mëparshme është e alokuar.

#### Neni 4

Shkalla e kamatës do të përcaktohet për çdo transhe veç e veç, në ditën e tërheqjes së mjeteve nga huaja, varësisht nga ajo se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variabile).

#### Neni 5

Projektin për rikonstruktim dhe ndërtim shtesë të institucioneve shëndetësore publike në Republikën e Maqedonisë - faza e parë, nga Marrëveshja Kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji, do ta realizojë Ministria e Shëndetësisë.

#### Neni 6

Republika e Maqedonisë huan do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".